

Datë 04.08.2026

## **MEMORANDUM NR.2**

*Mbi Udhëzimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Rregullores së Sigurisë së Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO)*

**DREJTUAR: Prof. Dr. Maksim HAXHIA**

**KRYETAR I DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË**

**NGA: Av. Plarent NDRECA**

*I nderuar Kryetar Haxhia,*

*Të nderuar kolegë, anëtarë të organeve drejtuese të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë,*

Në Memorandumin nr. 1 vura në vëmendjen e Dhomës Kombëtare të Avokatisë se, përmes praktikës së vendosjes së gjobave administrative ndaj avokatëve nga Gjykata e Posaçme, po konsolidohej një standard i ri që cenonte pavarësinë e profesionit të avokatit, barazinë e armëve dhe garancitë e procesit të rregullt ligjor. Fatkeqësisht, ajo që paraqitej si një praktikë gjyqësore problematike, sot është institucionalizuar përmes akteve administrative me karakter normativ. Fillimisht me Udhëzimin nr. 716, datë 06.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe tashmë me Rregulloren e re të Sigurisë së Gjykatës së Posaçme, e cila jo vetëm e ka përqaftuar atë model administrativ, por e ka zgjeruar dhe institucionalizuar në mënyrë edhe më të thellë.

Në vlerësimin tim, këto dy akte nuk mund dhe nuk duhet të analizohen të ndara. Rregullorja e GJKKO-së nuk përfaqëson një akt të izoluar, por është vijim dhe zbatim i drejtpërdrejtë i modelit normativ të krijuar nga Udhëzimi nr. 716/2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Të dy aktet ndërtojnë një regjim administrativ, i cili, nën emrin e administrimit të sigurisë dhe marrëdhënieve me publikun, pretendon të rregullojë publicitetin e gjyqimit, marrëdhëniet me median, ushtrimin e profesionit të avokatit, zhvillimin e seancës gjyqësore dhe vetë ushtrimin e funksionit gjyqësor.

Pikërisht mbi këtë bazë, analiza ime juridike arrin në përfundimin se si Udhëzimi nr. 716, datë 06.12.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ashtu edhe Rregullorja e Sigurisë së GJKKO-së paraqesin shkelje të rënda kushtetuese dhe ligjore, të cilat justifikojnë kundërshtimin e tyre institucional dhe gjyqësor. Thelbi i problemit qëndron në faktin se kufizime që ligjvënësi nuk i ka parashikuar me ligj

po krijohen gradualisht përmes akteve administrative të organeve të qeverisjes së sistemit gjyqësor dhe administratës së gjykatave.

Konkretisht:

**Së pari**, ato janë nxjerrë në mungesë të kompetencës për të rregulluar fusha që Kushtetuta dhe ligji ua rezervojnë ligjit dhe funksionit gjyqësor. KLGJ-ja është organ i qeverisjes së sistemit gjyqësor dhe jo organ që ushtron funksionin kushtetues të dhënies së drejtësisë. Për këtë arsye, ajo mund të miratojë standarde organizative ose teknike për administrimin e gjykatave (si institucion), por nuk mund të krijojë kufizime të reja mbi publicitetin e gjykimit, marrëdhëniet e trupit gjykues me median, filmimin ose transmetimin e seancës. Në të njëjtën mënyrë, Këshilli i Gjykatës, sipas nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, mund të miratojë vetëm rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e gjykatës, por jo të krijojë një regjim procedural që rregullon ushtrimin e profesionit të avokatit, të drejtat e medias, zhvillimin e seancës gjyqësore apo kompetencat e trupit gjykues.

**Së dyti**, të dy aktet cenojnë rezervën kushtetuese. Nenet 17, 22 dhe 23 të Kushtetutës kërkojnë që çdo kufizim i të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit dhe publicitetin e gjykimit, të vendoset vetëm me ligj, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcional. As KLGJ-ja dhe as Këshilli i Gjykatës nuk mund të krijojnë me akte administrative kufizime që ligjvënësi nuk i ka autorizuar shprehimisht.

**Së treti**, këto akte përmbysin parimin kushtetues të publicitetit të gjykimit. Neni 5 i ligjit nr. 98/2016 dhe nenet 339 e 340 të Kodit të Procedurës Penale e trajtojnë publicitetin si rregull dhe kufizimin e tij si përjashtim, vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht nga ligji. Udhëzimi i KLGJ-së dhe Rregullorja e GJKKO-së e përmbysin këtë raport, duke e kthyer publicitetin nga një garanci kushtetuese në një regjim autorizimi, kontrolli dhe vendimarrje administrative.

**Së katërti**, ato ndërhyjnë drejtpërdrejt në ushtrimin e funksionit gjyqësor. Në momentin që një akt administrativ fillon të përcaktojë mënyrën e zhvillimit të seancës, praninë e medias dhe publikut, gjykimin hibrid, përdorimin e mjeteve të punës së avokatit apo administrimin procedural të gjykimit, ai nuk administron më gjykatën si institucion, por gjyqtarin si dhënësi i drejtësisë. Një ndërhyrje e tillë bie ndesh me nenet 42 dhe 145 të Kushtetutës dhe shfuqizon ndarjen ndërmjet funksionit administrativ dhe atij gjyqësor duke cënuar drejtpërdrejt pavarësinë individuale të gjyqtarit.

**Së fundi**, të dy aktet cenojnë regjimin kushtetues të akteve normative. Nëse konsiderohen akte të brendshme administrative, ato nuk mund të prodhojnë efekte juridike ndaj të tretëve. Nëse pretendojnë të krijojnë detyrime për median, avokatët, publikun ose palët në proces, atëherë ato duhet të mbështeten në një autorizim të shprehur ligjor, të qëndrojnë brenda kufijve të delegimit dhe t'i nënshtrohen regjimit kushtetues të hyrjes në fuqi dhe publikimit të akteve normative. Ato nuk mund të zbatohen si burime autonome kufizimesh ndaj të drejtave kushtetuese.

Pikërisht këto shkelje komulative: mungesa e kompetencës materiale, cenimi i rezervës kushtetuese, ndërhyrja në të drejta dhe liri themelore, cenimi i pavarësisë së gjyqtarit dhe shmangia e regjimit kushtetues të akteve normative, e nxjerr këtë çështje jashtë debatit të zakonshëm mbi ligjshmërinë administrative dhe e vendos në planin e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve.

Kjo problematikë nuk ka lindur me miratimin e Rregullores së GJKKO-së. Ajo është paralajmëruar prej kohësh në kërkesat që i kam drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kuvendit të

Shqipërisë, ku kam argumentuar se neni 14 i Vendimit nr. 716, datë 06.12.2023, krijonte një bazë normative të papajftueshme me Kushtetutën për kufizimin administrativ të publicitetit të gjykimit. Modeli kufizues i krijuar nga KLGJ-ja është marrë si bazë, është zgjeruar përtej kufijve të tij fillestarë dhe është institucionalizuar në mënyrë edhe më të rëndë nga administrata e Gjykatës së Posaçme.

Nëse ky model pranohet, ai nesër mund të replikohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë, duke e shndërruar një praktikë të paligjshme në standard administrativ të funksionimit të sistemit gjyqësor. Pikërisht për këtë arsye dhe në përputhje me misionin që ligji i ngarkon për mbrojtjen e pavarësisë dhe lirisë së profesionit të avokatit, vlerësoj se Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të ndërmarrë këto veprime institucionale:

- të mbajë një qëndrim publik institucional mbi antikushtetutshmërinë e Udhëzimit nr. 716, datë 06.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Rregullores së Sigurisë së Gjykatës së Posaçme;
- t'u kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Posaçme ndryshimin e menjëhershëm të dispozitave që cenojnë, pavarësinë e avokatit, medias, gjyqtarit, si dhe publicitetin e gjykimit;
- të ushtrojë të drejtën e saj për ngritjen e padisë administrative me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve dhe njëkohësisht pezullimin e zbatimit të tyre;
- të garantojë mbështetje institucionale për çdo avokat ndaj të cilit merren masa në zbatim të këtyre akteve, duke ndërhyrë në çdo procedurë administrative ose gjyqësore ku cenohen pavarësia e profesionit të avokatit.
- të iniciojë një tryezë të përbashkët institucionale me KLGJ-në, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese, organizatat e medias dhe partnerët ndërkombëtarë për rishikimin e plotë të standardeve që rregullojnë publicitetin e gjykimit dhe ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e Këshillit të Evropës.

**I nderuar Kryetar,**

**Të nderuar kolegë,**

Askush nuk vë në diskutim detyrimin e shtetit për të garantuar sigurinë e gjykatave dhe të çdo institucioni tjetër publik. Por siguria nuk mund të shndërrohet në burim autonom kompetencash për administratën e gjykatës dhe as si justifikim për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore. Rendi kushtetues shqiptar i qëndron parimit se të drejtat dhe liritë themelore përbëjnë themelin e shtetit të së drejtës dhe se çdo kufizim i tyre mund të vendoset vetëm me ligj, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

Kur vetë administrata e gjykatës tejkalon kompetencat dhe ndërhyr në fusha të rezervuara Kushtetutës, ligjit dhe funksionit gjyqësor, reagimi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë mbetet një detyrim ligjor dhe profesional, ndaj kolegëve avokatë, ndaj qytetarëve që kanë të drejtë për një mbrojtje efektive dhe ndaj vetë shtetit të së drejtës.

**Me konsideratë të lartë,**

**Av. Plarent NDRECA**